



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

MARS, 2026

Buletini Muor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin mars 2026 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP apo të tjerë. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara, dhe në disa raste edhe ato të dyshuara dhe të mundshme sipas përkufizimit të rastit.

1. Sëmundjet diarreike

Për muajin mars incidenca e sëmundjeve diarreike është 229.5 raste për 100,000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike me incidencë 229.13 / 100000 banorë. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës për muajin mars 2026 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin mars 2026
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste mars 2026	Incidenca mars 2026 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.0
Salmoneloza	4	0.2
Shigelozë (Disenteri bacilare)	0	0.0
Toksiko-infeksione alimentare	6	0.2
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	5504	229.1
Sëmundje diarreike në total	5514	229.5

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit mars 2026 janë raportuar në total 196 raste të dyshuar me variçelë (incidenca 8.16/ 100.000 banorë). Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 59 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 103 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës



2.2 Fruthi

Gjatë muajit mars janë raportuar 35 raste të dyshuara nga të cilat janë konfirmuar 28 raste nga ana laboratorike me metodën ELISA. 25 raste janë konfirmuar pranë laboratorit të virologjisë në ISHP, dhe 3 raste në laboratorë jopublik. Incidenca në muajin mars është 1.17 raste /100 000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas datës së fillimit të rashit



Siç shihet edhe nga kurba epidemike rastet janë në rritje gjatë muajit mars.

Tabela 2. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruthit sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Durrës	2	1.30
Elbasan	6	5.21
Krujë	1	1.95
Kukës	1	2.77
Lezhë	1	1.95
Shkodër	1	0.98
Tiranë	16	2.67
Total	28	1.17

Rastet i përkasin kryesisht bashkisë Tiranë, por incidencën më të lartë e ka bashkia Elbasan me 5.21 raste /100 000 banorë.

Tabela 3. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruthit sipas grup-moshës

Grup-mosha,vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç	17	15.2
5-14 vjeç	8	3.1
15-24 vjeç	2	
25-44 vjeç	1	
45-59 vjeç		
60 + vjeç		
Total	28	1.2

Shumica e rasteve janë të grup-moshës pediatrike 0-14 vjeç, 22 raste (78.6%) janë të pavaksinuar dhe 3 (10.7%) raste janë me dy doza vaksine FRP dhe 3 raste (10.7%) me një dozë. Të dhënat e vaksinimit janë verifikuar në sistemin elektronik të informacionit mbi vaksinat (SIV).

Gjithashtu 15 (53.5%) raste janë të shtruar në spital, ndërsa 7 (46.5%) prej tyre u ndoqën në rrugë ambulatorë.

Hetimi epidemiologjik i rasteve është kryer nga shërbimi i epidemiologjisë në NJVKSH përkatese ku janë identifikuar kontaktet dhe janë marrë masat e kontrollit të infeksionit.

3. Hepatitet virale

3.1 Hepatiti viral A (HAV)

Në muajin mars është raportuar një rast i konfirmuar me HAV. Rasti është i moshës 29 vjeç, femër nga bashkia Tiranë, e shtruar në spitalin infektiv QSUT.

Nga hetimi epidemiologjik i rastit nuk ka patur raste të tjera, rasti është sporadik.

3.2 Hepatiti viral B (HBV)

Në muajin mars janë raportuar 22 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në këtë muaj është 0.92 raste/100 000 banorë në vend.

Prej tyre 9 raste janë të gjinisë mashkull (41%) dhe 13 femra (59%).

Tabela 4. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca (raste/100 000 banorë) me HBV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Fier	1	0.98
Mat	1	5.75
Lushnjë	2	3.17
Tiranë	18	3.01
Total	22	0.92

Në muajin mars rastet janë të shpërndara në disa bashki (tabela 1), ku numrin më të lartë e ka Tirana me 18 raste, ndërkohë incidenca është më lartë në Mat me 5.75 raste /100 000 banorë.

Tabela 5. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca (raste/100 000 banorë) me HBV sipas grup-moshave (vite)

Grup-mosha,vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç	1	0.35
25-44 vjeç	6	1.02
45-59 vjeç	8	1.64
60 + vjeç	7	1.05
Total	22	0.92

Rastet në muajin mars i përkasin grup-moshës adulte (tabela 2) dhe mungesa e tyre në grup-moshat pediatrike, kjo në sajë të vaksinimit ndaj HBV në këto grup-mosha. Rasti në grup-moshën 15-24 vjeç i përket i moshës 24 vjeç.

Incidenca është më e lartë në grup-moshën 45-59 vjeç dhe përkatësisht 1.64 raste për 100 000 banorë. Të gjitha rastet e konfirmuara të raportuara janë testuar për arsye diagnoze dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut B.

3.3 Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin mars janë raportuar 7 raste të konfirmuar me HCV. Incidenca e HCV për këtë muaj është 0.29 raste /100000 banorë.

Katër raste (43%) i përkasin gjinisë mashkull dhe 3 raste (57%) asaj femër.

Tabela 6. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca me HCV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Tiranë	7	1.17
Total	7	0.29

Rastet i përkasin bashkisë Tiranë, me incidencë 1.17 raste/100 000 banorë.

Tabela 7. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca me HCV sipas grup-moshave (vite)

Grup-mosha,vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç	1	0.35
25-44 vjeç	3	0.51
45-59 vjeç		
60 + vjeç	3	0.45
Total	7	0.29


Gjatë muajit mars, rastet janë të shpërndara në grup-moshat adulte (tabela 2) ku incidenca më e lartë i përket grup-moshës 25-44 vjeç me 0.51 raste /100 000 banorë.

Të gjitha rastet e konfirmuara të raportuara janë testuar për arsye diagnoze dhe përmbushnin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut C.

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme


Gjatë muajit mars 2026 janë kryer 21 ekzaminime për HIV (14 meshkuj dhe 7 femra) prej të cilëve 10 raste (8 meshkuj dhe 2 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv.

Grafiku 3. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin mars 2026



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është: 5 raste Tiranë, 1 rast Durrës, 1 rast Elbasan, 1 rast Sarandë dhe 2 raste me shtetësi të huaj (me vendbanim të përkohshëm në vendin tonë).

Grafiku 4. Shpërndarja gjeografike e rasteve të konfirmuara në muajin mars 2026



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 6 raste i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 35-44 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç, 2 raste i përkasin grup-moshës mbi 65 vjeç.

Rastet e konfirmuara janë referuar si më poshtë: 5 raste vijnë nga laboratorë/spitale private (3 raste Genius, 1 rast CAMBRIDGE dhe 1 rast INTERMEDICA), 3 raste vijnë nga Klinika Ambulatore Infektiv, 1 rast është referuar nga shoqata ALGBT, dhe 1 rast referuar nga NJVKSH Tiranë.

Sifiliz

Gjatë muajit mars 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 10 raste të konfirmuara me Sifiliz.

Rastet e raportuara, të konfirmuara, janë 7 meshkuj e 3 femra. Shpërndarja sipas grup-moshave është nga 2 raste për grup-moshat 15-24 vjeç, 45-54 vjeç dhe 65-74 vjeç dhe në grup-moshën 25-34 vjeç janë 4 raste. Rastet vijnë nga bashkitë: Tiranë, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë.

Infeksion nga gonokokou si gonorrhe etj. (Neisseria gonorrhoeae)

Gjatë muajit mars 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive një rast i konfirmuar me N.gonorrhoeae në bashkinë Tiranë i gjinisë mashkull, mosha 39 vjeç.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit mars 2026 janë raportuar gjithsej 14 raste me tuberkuloz (TB). Të gjitha janë raste pulmonare, të konfirmuara me ekzaminime laboratorike.

Rastet pulmonare janë të shpërndara përkatësisht: 3 në Tiranë, 2 në Shkodër, 1 në Laç, 2 raste në Durrës, 2 në Kukës, 1 në Elbasan, 1 në Korçë, 1 në Mat dhe 1 në Bulqizë.

Raste ekstrapulmonare dhe raste recidiv për muajin mars nuk ka.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria dhe NJVKSH-të e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB këtë muaj janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 8. Shpërndarja e zoonozave në muajin mars 2026, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecizioë)

	Mars (raste 2026)	Incidenca (raste/100,000) 2026
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	10	0.42
Leptospirozë	0	0.00


Për muajin mars janë raportuar 10 raste Brucelozë përkatësisht : 2 nga Gjirokastra, 1 nga Kolonja , 2 raste nga Korça, 2 Kukës, 1 Përmet dhe 2 Himarë.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19

Gjatë muajit mars 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 9 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin mars është 0.37 raste /100000 banorë.


Grafiku 5. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 35-44 vjeç me incidencë 1.03 raste/100000 banorë, 34-74 vjeç me incidencë 1.01 raste/100000 banorë.

Gjatë këtij muaji asnjë rast nuk është shtruar në spital.

Grafiku 6. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive



Incidencën më të madhe të rasteve e ka bashkia Skrapar e ndjekur nga bashkitë Poliçan, Shijak, dhe Pogradec.

Gjatë muajit mars 2026 është raportuar zero raste vdekjeje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 100% (9 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve dhe asnjë rast nuk është konfirmuar në laboratorin e ISHP-së.

7.2 Grip

Gjatë muajit mars janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 290 raste të dyshuara me Grip, nga të cilat 9 raste kanë rezultuar pozitive dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin mars është 0.37raste /100000 banorë. Në muajin mars qarkullimi i gripit arriti intensitet të ulët duke paraqitur aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën, dhe përhapje gjeografike rajonale.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Sëmundje Meningokoksike Invazive (Neisseria Meningitidis)

Gjatë muajit mars 2026 është raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 1 rast i konfirmuar me Sëmundje Meningokoksike Invazive (Neisseria Meningitidis). Rasti është i grup-moshës 0-4 vjeç dhe banues në bashkinë Gramsh. Janë marrë masat e kontrollit sipas

protokollit të ndjekjes së rastit me meningokoksemi duke përfshirë dhe profilaksinë e kontakteve të ngushta.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI